

LIGJ
Nr. 84/2025

PËR MARRËVESHJEN E PAQES FISKALE

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 155 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti i ligjit

Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave dhe i procedurave për lidhjen e marrëveshjes vullnetare ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore për pagimin e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, bazuar në vlerësimin e fitimit të tatueshëm, si dhe të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të tri viteve të mëparshme.

Ky ligj nuk sjell asnjë lloj imuniteti administrativ, tatimor ose penal ndaj veprimeve të tatimpaguesve për pastrimin e parave, financimin e terrorizmit apo për çdo vepër tjetër penale që lidhet me origjinën e paligjshme të pasurisë. Administrata tatimore informon rastet e dyshimeve të arsyeshme pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare.

Neni 2
Qëllimi i ligjit

Qëllimi i këtij ligji është të nxisë përmbushjen vullnetare të detyrimeve për tatimin mbi të ardhurat e korporatave ose tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe rivlerësimit të pasqyrave financiare nëpërmjet një marrëveshjeje njëvjeçare, kundrejt mosushtimit të kontrollit tatimor për këtë tatim gjatë vitit tatimor të marrëveshjes.

Neni 3
Fusha e zbatimit të ligjit dhe kohëzgjatja e marrëveshjes së paqes

1. Ky ligj zbatohet për tatimpaguesit, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në territorin e Republikës së Shqipërisë, të cilët:

- a) janë të regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit;
- b) i nënshtrohen tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi sipas dispozitave të ligjit për tatimin mbi të ardhurat dhe nuk përfitojnë nga normat e reduktuara, e përjashtimet sipas nenit 69, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar;
- c) përmbushin kushtet dhe kriteret e përcaktuara në këtë ligj e në aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Marrëveshja e paqes fiskale zbatohet për një vit tatimor, me të drejtë rinovimi për 2 (dy) vite tatimore.

Neni 4
Përkufizime

Në kuptim të këtij ligji, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “Marrëveshje e paqes fiskale” është marrëveshja vullnetare ndërmjet tatimpaguesit dhe administratës tatimore, me kërkesë të tatimpaguesit, me efekt detyrues për një vit tatimor, për vlerësimin e fitimit të tatueshëm, normën dhe pagimin e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose të tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, si dhe të drejtën për rivlerësimin e pasqyrave financiare të tri viteve të mëparshme;

b) “Tatimpagues” është çdo person fizik ose entitet, që është subjekt i detyrimit të tatimit mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi, sipas legjislacionit tatimor në fuqi dhe që plotëson kushtet për të hyrë në marrëveshje;

c) “Administrata tatimore” është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe strukturat e saj territoriale e qendrore;

ç) “Vlerësimi i fitimit të tatueshëm” është vlerësimi i fitimit të tatueshëm për vitin tatimor, të llogaritur sipas dispozitave të parashikuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat, për të cilin lidhet marrëveshja, bazuar në një përqindje rritjeje në krahasim me vitin paraardhës, sipas kushteve të përcaktuara në këtë ligj;

d) “Normë tatimore e marrëveshjes” është:

i. përqindja standarde e tatimit mbi të ardhurat e korporatave ose tatimit mbi të ardhurat e biznesit, që zbatohet mbi fitimin e tatueshëm të vlerësuar, deri në një përqindje të caktuar rritjeje në krahasim me vitin e mëparshëm; si dhe

ii. 5% për çdo rritje të fitimit të tatueshëm të vlerësuar mbi përqindjen e rritjes së caktuar në këtë ligj;

dh) “Rinovimi i marrëveshjes” është procedura për lidhjen e një marrëveshjeje të re vjetore, për aq kohë sa tatimpaguesi përmbush kushtet e kriteret e përcaktuara dhe dorëzon një aplikim të ri;

e) “Afat i vlefshmërisë” konsiderohet viti tatimor gjatë të cilit marrëveshja prodhon efektet e saj tatimore e procedurale.

KREU II REGJIMI MATERIAL I MARRËVESHJES

Neni 5

Fitimi i tatueshëm dhe tatimi gjatë marrëveshjes së paqes fiskale

1. Tatimpaguesit, në mënyrë vullnetare, aplikojnë nëpërmjet platformës elektronike “*e-filing*” për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

2. Fitimi i tatueshëm i vlerësuar është fitimi i tatueshëm i vitit të mëparshëm i rritur me 18% në krahasim me fitimin e tatueshëm të vitit paraardhës tatimor.

3. Tatimi mbi fitimin e tatueshëm të korporatës ose tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi llogaritet si shumëzim i normës, sipas përcaktimeve në ligjin nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me fitimin e tatueshëm me rritje deri në 18%, sipas përcaktimeve të pikës 2 të këtij neni.

4. Për çdo fitim të tatueshëm, që tejkalon vlerën e parashikuar sipas pikës 2 të këtij neni, zbatohet norma tatimore prej 5%.

5. Administrata tatimore, mbi bazën e formulës së vlerësimit, të përcaktuar në pikat 2, 3 dhe 4 të këtij neni, harton dhe i propozon tatimpaguesit vlerën e paracaktuar të fitimit të tatueshëm, që përdoret për llogaritjen e detyrimit tatimor gjatë periudhës së marrëveshjes.

6. Detyrimi tatimor është tatimi mbi të ardhurat e korporatave ose tatimi mbi të ardhurat personale nga biznesi dhe nuk prek detyrimet e tjera tatimore.

Neni 6

Rideklarimi i elementeve të veçanta të pasqyrave financiare vjetore

1. Tatimpaguesit, të cilët lidhin marrëveshjen e paqes fiskale, kanë të drejtë të bëjnë rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë, për deri në tri vitet e mëparshme tatimore. Në aplikimin e tyre për lidhjen e marrëveshjes, sipas pikës 1, të nenit 5 të këtij ligji, tatimpaguesi duhet të shprehet se do të kryejë edhe rideklarimin e pasqyrave financiare.

2. Për çdo diferencë deri në 30%, që lind nga gjendja reale me gjendjen aktuale kontabël, diferencë, e cila jep efekt neto në rritje në të ardhura apo kapital, subjektit i lind detyrimi për pagesë të tatimit si më poshtë:

a) aktive monetare, rideklarim i gjendjes së *cash*-it të shoqërisë, si në ulje apo në rritje. Tatim në masën 5% të çdo devijance negative apo pozitive nga gjendja reale e *cash*-it;

b) aktivet e tjera financiare – fshirja e shumave të parregullta në zërin kërkesa të arkëtueshme. Tatim në masën 5% për fshirjen e detyrimeve të parregullta;

c) fshirja e aktiveve afatgjata materiale/jomateriale të parregullta të deklaruara. Tatim në masën 5% përkundrejt fshirjes së inventarit të parregullt;

ç) deklarim i aktiveve afatgjata materiale të papërfshira në pasqyrat financiare. Tatim në masën 5% për përfshirjen e aktivit afatgjatë material/jomaterial;

d) fshirja e detyrimeve të parregullta/borxheve në pasqyrat financiare. Fshihen detyrimet duke i konsideruar të ardhura të patatueshme përkundrejt pagesës së tatimit në masën 5%;

dh) rideklarim i fitimit të mbartur të shoqërisë dhe shpërndarja si dividend/fitim i tij. Tatim në masën 5% për dividendin dhe ndarjen e fitimeve.

3. Çdo diferencë e kontabilizuar, bazuar në kuadrin rregullator të kontabilitetit të sektorit privat për këtë qëllim, do të klasifikohet si e ardhur e patatueshme apo shpenzim i pazbritshëm për qëllime të deklaratës së tatimit apo tatimit të thjeshtuar të fitimit.

4. Shumat e detyrimeve ndaj ortakëve të shoqërisë, të rivlerësuara sipas dispozitave të këtij neni, mund të përdoren lirisht prej tyre për qëllime të biznesit apo personale.

5. Asnjë rideklarim pozicionesh nuk mund të japë në periudhat e kaluara periudhën korrente apo periudhat e ardhshme efekte në rritjen e shpenzimeve apo elementeve të tjera, që reduktojnë fitimin tatimor apo TVSH-në e pagueshme.

6. Për të gjitha transaksionet e mësipërme nuk do të aplikohen dënimet administrative sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore dhe nuk ushtrohet kontroll tatimor.

Neni 7

Kriteret për përfitimin nga marrëveshja

Kanë të drejtën të aplikojnë për marrëveshjen e paqes fiskale tatimpaguesit, që plotësojnë njëherazi kushtet e mëposhtme:

a) janë persona fizikë dhe entitete të regjistruara në regjistrin tatimor dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike në Republikën e Shqipërisë;

b) nuk kanë detyrime tatimore të papaguara ose të padeklaruara;

c) nuk janë në proces ankimimi administrativ;

ç) nuk janë subjekt i procedimeve penale për vepra në fushën tatimore.

d) nuk janë dënuar me vendim të formës së prerë për mashtrim tatimor, pastrim të produkteve të veprës penale ose fshehje të ardhurash;

dh) nuk janë subjekt hetimi nga administrata tatimore;

e) nuk realizojnë projekte koncesionare.

Neni 8

Detyrimet tatimore të përfshira në marrëveshje

Marrëveshja e paqes fiskale përfshin:

- a) vlerësimin dhe paracaktimin e fitimit të tatueshëm, që rezulton nga veprimtaria ekonomike e tatimpaguesit;
- b) normën tatimore për tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimit mbi të ardhurat personale nga biznesi;
- c) të drejtën për rideklarimin e elementeve të veçanta të aktiveve, të detyrimeve apo të kapitaleve të veta të pasqyrave financiare vjetore të shoqërisë, sipas normës së tatimit dhe procedurës së përcaktuar në këtë ligj.

§Neni 9

Efektet juridike dhe kufizimi i kontrolleve tatimore

1. Gjatë vlefshmërisë së marrëveshjes së paqes fiskale, për tatimin mbi të ardhurat e korporatave dhe tatimin mbi të ardhurat personale nga biznesi nuk kryhen kontrole tatimore në terren, përveç rasteve kur për tatimpaguesin është regjistruar një çështje hetimore në proces për konsumin e veprës penale të krijimit të skemave mashtruese me tatimin mbi vlerën e shtuar apo fshehje e të ardhurave, sipas parashikimeve në Kodin Penal.
2. Subjektet e parashikuara në këtë ligj i nënshtrohen monitorimit periodik nga zyra gjatë të gjithë periudhës së marrëveshjes. Vlerësimi/verifikimi nga zyra për qëllime monitorimi do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

Neni 10

Përfundimi i vlefshmërisë së marrëveshjes

1. Marrëveshja e paqes fiskale përfundon në rastet e mëposhtme:
 - a) tatimpaguesi ndryshon llojin e veprimtarisë së deklaruar në marrëveshje;
 - b) tatimpaguesi nuk realizon rritjen me mbi 18% të fitimit të tatueshëm;
 - c) tatimpaguesi pezullon apo ndërpret përfundimisht aktivitetin ekonomik;
 - ç) ka kryer shkelje të përsëritura të detyrimeve tatimore, që cenojnë ndershmërinë fiskale;
 - d) nuk paguan detyrimet sipas marrëveshjes;
 - dh) nuk përmbush më kushtet e parashikuara në nenin 6 të këtij ligji;
 - e) ka realizuar një rritje të fitimit të tatueshëm mbi 50% gjatë vitit tatimor për të cilin është lidhur marrëveshja, krahasuar me vitin tatimor paraardhës.
2. Në rast se marrëveshja përfundon sipas rasteve të pikës 1 të këtij neni, për pasqyrat e rivlerësuara në përputhje me nenin 6 të këtij ligji administrata tatimore kryen kontrollin dhe rivlerësimin e detyrimit tatimor, në përputhje me normat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për tatimin mbi të ardhurat.
3. Ministri përgjegjës për financat përcakton me udhëzim procedurat për zbatimin e këtij neni.

KREU III

PROCEDURA E LIDHJES DHE ADMINISTRIMIT TË MARRËVESHJES

Neni 11

Zbatimi dhe propozimi i marrëveshjes

1. Aplikimi për lidhjen e marrëveshjes së paqes fiskale bëhet nga tatimpaguesi nëpërmjet platformës elektronike “*e-filing*” brenda afatit për dorëzimin e deklaratës vjetore të të ardhurave të vitit paraardhës, sipas legjislacionit në fuqi. Për vitin e parë tatimor të zbatimit, afati përcaktohet me udhëzim të drejtorit të përgjithshëm të Tatimeve.
2. Propozimi i marrëveshjes së paqes fiskale hartohet nga administrata tatimore.
3. Propozimi i formuluar i komunikohet tatimpaguesit përmes platformës elektronike “*e-filing*” dhe përmban vlerën e fitimit të tatueshëm, si dhe normat e detyrimit tatimor për periudhën përkatëse.

4. Procedurat për hartimin dhe përmbajtjen e propozimit të marrëveshjes, mënyrat e komunikimit me tatimpaguesin e konfirmimin elektronik, regjistrimin dhe ruajtjen e marrëveshjes në regjistrin elektronik tatimor, trajtimin e rasteve të refuzimit, mospranimit ose pavlefshmërisë së marrëveshjes, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës për financat.

Neni 12

Efektet e pranimit të marrëveshjes

1. Tatimpaguesi ka të drejtë të pranojë ose të refuzojë propozimin e marrëveshjes së paqes fiskale nga administrata tatimore brenda datës 15 prill.

2. Me pranimin nëpërmjet nënshkrimit elektronik, marrëveshja konsiderohet e lidhur dhe ka efekt ligjor për vitin tatimor përkatës.

3. Tatimpaguesi ka detyrimin të deklarojë dhe të paguajë detyrimin tatimor sipas marrëveshjes së paqes fiskale, sipas nenit 63, të ligjit nr. 29/2023, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar.

4. Të dhënat e deklaruarat i nënshtrohen kontrollit nga zyra nga administrata tatimore, sipas legjislacionit në fuqi.

5. Mospërmbushja e detyrimeve të deklarimit apo pagesës, sipas marrëveshjes së pranuar, trajtohet si shkelje tatimore dhe u nënshtrohet dispozitave përkatëse të legjislacionit në fuqi për procedurat tatimore.

KREU IV

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 13

Transparenca publike dhe monitorimi

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve publikon në faqen e saj zyrtare, mbi baza periodike 6-mujore, raportime statistikore, lidhur me zbatimin e këtij ligji, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të dhënat personale dhe ligjit për procedurat tatimore.

Neni 14

Aktet nënligjore

1. Ngarkohet ministri përgjegjës për financat të miratojë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, aktet nënligjore në zbatim të neneve 10, pika 3, dhe 11, pika 4, të këtij ligji.

2. Ngarkohet drejtori i përgjithshëm i Tatimeve të miratojë, brenda 3 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, udhëzimin në zbatim të pikës 1, të nenit 11 të këtij ligji.

Neni 15

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet deri në vitin tatimor 2028.

Miratuar në datën 11.12.2025.

Shpallur me dekretin nr. 21, datë 12.1.2026, të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bajram Begaj.